



Newsletter Tetor 2019



Në Fokus

Transparencë në prokurime për zhvillim të qëndrueshëm

Të reja nga projektet

Pas 30 vitesh, drejt zgjidhjes problemi i furnizimit me ujë për 85 mijë banorë në zonat rurale

Impakt/Histori njerëzore

Asnjë problem nga stuhia e fundit!

Banorët e Fushë-Krujës pas vitesh përmbytje, të sigurtë në banesa

A e dini se?

Kush ndihmon për shpëtimin e një jete, është njësoj sikur ka shpëtuar gjithë njerëzimin

Transparencë në prokurime për zhvillim të qëndrueshëm

Zbatimi i rregullave të barabarta për të gjithë çon në përdorimin e zgjuar të fondeve të destinuar për zhvillim, që shpesh janë të kufizuara në krahasim me nevojat.

Transparenca në prokurime është pjesë thelbësore e zhvillimit të qëndrueshëm. Përmes procedurave transparente të prokurimit mundësohet përdorimi me efikasitet i parave publike, nxitet konkurrenca e ndershme dhe zhvillimi ekonomik. Fondi Shqiptar i Zhvillimit e ka transparencën një ndër vlerat kryesore të punës.

Gjatë 9 mujorit të parë të vitit 2019 janë realizuar rreth 13,5 mld lekë procedura prokurimesh për punime civile, që përbën rreth 97% të procedurave në total të realizuara në 32 kontrata.

Në këto procedura kanë marrë pjesë 259 operatorë ekonomikë, ku mbi 57% prej tyre janë kualifikuar, me një mesatare prej 5 operatorësh të kualifikuar për çdo procedurë. Në total janë shpallur 38 kompani fituese për 32 kontrata për punimet civile.

Transparenca ndihmon në përdorimin e zgjuar të fondeve të destinuar për zhvillim, që shpesh janë të kufizuara në krahasim me nevojat. Me fjalë të tjera, duke zbatuar rregulla loje të barabarta për të gjithë, rritet konkurrenca e ndershme dhe cilësia e shërbimeve të ofruara përkundrejt vlerës në dispozicion.


Në këtë aspekt vlera e fondit limit në total për procedurat e punimeve civile është rreth 18,5 mld lekë. Ndërkohë, shuma e vlerave të kontratave të lidhura për këto procedura është rreth 13,5 mld lekë, duke sjellë një kursim prej rreth 5 miliardë lekësh, ose rreth 30% e fondit limit.

Për më shumë info:

<https://www.albaniandf.org/2019/06/10/regjistri-i-kontratave/>

	Numri i prokurimeve të kryeragjatë 9-mujorit të parë të 2019	32
	Operatorë ekonomikë që kanë marrë pjesë në proces	259
	Operatorë të shpallur fitues	38
	Vlera e fondit limit për procedurat e punimeve civile	18.5 Miliard LEK
	Vlera e kontratave të lidhura për procedurat e punimeve civile	13.5 Miliard LEK
	Kursyer nga fondi limit	30%

■ Të kualifikuar
■ Të skualifikuar




Grafiku 1. % e kualifikimit të Operatorëve Ekonomikë

Pas 30 vitesh, drejt zgjidhjes problemi i furnizimit me ujë për 85 mijë banorë në zonat rurale

Transferimi i përgjegjësiwe për menaxhimin e shërbimeve të ujësjellësve dhe kanalizimeve nga qeverisja qendrore në qeverisjen lokale pas ndryshimeve politike dhe socio-ekonomike të viteve '90-të në Shqipëri krijoi një boshllëk në investimet për mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese dhe përmirësimin e saj. Si rezultat, rrjetet ekzistuese të furnizimit me ujë në zonat rurale mbetën të lëna pas dore, ndërsa banorët pa akses në ujin e pijshëm. Programi për Furnizimin me Ujë të Zonave Rurale III filloi vitin e kaluar me një financim prej 39.97 mln Eurosh nga Qeveria Shqiptare dhe ajo gjermane përmes një kredie nga KfW, si dhe Bashkimi Europian, Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF) dhe bashkitë e përzgjedhura si pjesë e programit.

FUZR III vjen pas zbatimit me sukses të dy fazave të mëparshme në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Ndërsa FUZR I dhe FUZR II u përqëndruan kryesisht në zonat veriore të vendit, FUZR III ka një shtrirje në 83 fshatra të 15 bashkive nga veriu në jug të vendit. Deri tani janë realizuar rreth 40% e punimeve, të cilat parashikohet të përfundojnë në mes të vitit 2021. Të gjitha ndërhyrjet që shtrihen në bashkitë e qarqeve Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Korçë, Fier, Berat dhe Vlorë, synojnë të sigurojnë furnizim me ujë 24 orë mbi 85,000 banorë, sipas standardeve më të mira higjieno-sanitare. Bashkitë përfituese u përzgjedhën përmes një sistemi pikëzimi të mirëmbëdruar, ku mundësia e ndërtimit të skemave me rënie të lirë dhe kapacitetet e menaxhimit ishin ndër kriteret kryesore. FSHZH bashkëpunon ngushtë me bashkitë e përzgjedhura, të cilat janë njëkohësisht edhe pjesë e financimit me 10% të shumës.



Programi i furnizimit me ujë të zonave rurale (FUZR III)



Krahas punimeve inxhinierike për ndërtimin e depove, linjave të shpërndarjes nga burimi te konsumatori dhe vendosjes së matësve, programi parashikon edhe zbatimin e masave shoqëruese për rritjen e kapaciteteve menaxhuese në 7 bashki kryesore. Këto masa shoqëruese kanë për qëllim të rrisin kapacitetet e menaxhimit të ujësjellësve për një shërbim cilësor për konsumatorët dhe me tarifa të pranueshme, si dhe mbulimin e kostove operative duke siguruar jetëgjatësinë e investimit.

Asnjë problem nga stuhia e fundit!

Banorët e Fushë-Krujës pas vitesh përmbytje, të sigurtë në banesa

“Ngeli duke u na përmbyt malli dhe lagështi gjithandej. Lumi këtu ka qenë dhe më përpara o nën, po kanë ardhur e i kanë bërë shtëpijat ngjit më ngjit e ja tani. Shyqyr kanë ardhur këta çunat, e po punojnë. Avash avash janë duke e zgjidhur.” *Nëna Zelfije*

“Kemi pa vdekjen me sy. E beson dot?! Kam nxjerrë 9 njerëz prej këtëj me fadroma. Jemi përmbytur dy herë në vit. Flitet për jetë njerëzish këtu.” *Z. Hysen*

“Hymë në borxhe, po duhej të ndërtonim patjetër katin e dytë, të rrinim aty sa të tërhiqej uji. Herën e fundit përmbytja na la pas, lluc e besoni dhe gjarpërinj na kanë ardhur aty. Tani jemi rehat se ngelëm me sytë nga lumi.” *Banore e zonës*

“Ky është një investim jetik, që “shpëton” një qytet të tërë. Lumi Zezë ishte kthyer në makth çdo dimër, duke sjellë situatë të vështirë për familjet dhe bizneset e vogla.” *Kryetar i Bashkisë Krujë Artur Bushi*



Për më shumë info:

<https://www.albaniandf.org/2019/10/17/deri-dje-kati-i-pare-ishte-per-lumin-i-dyti-per-familjen/>

Kush ndihmon shpëtimin e një jete, është njësoj si të ketë shpëtuar gjithë njerëzimin

A e dini se?

400-450 ml gjak nuk janë asgjë për një njeri të shëndetshëm, por janë të çmuara për dikë që ka nevojë rregullisht për gjak, siç janë 600 pacientët me talasemi në Shqipëri. Jeta e tyre është e varur nga transfuzioni i gjakut të paktën dy herë në muaj.

Gjatë tetorit stafi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit iu bashkua Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut për të rritur numrin e dhurimeve. Pas ekzaminimeve, 23 punonjës dhanë kontributin e tyre në këtë nismë të përbashkët. Procesi i dhurimit zgjat 10 minuta për një individ dhe nuk ka pasoja negative në shëndet. Dhurimi i gjakut 2 herë në vit ndihmon shëndetin e zemrës, rrit prodhimin e qelizave të reja dhe ul rrezikun e sëmundjeve.

